



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government



Komuna Obiliq - Opština Obilič - Municipality Obiliq
Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër

Data :	21.11.2018
Për:	z.Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit
Nga:	z.Arben Berisha, Drejtor i Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Pronë
Lënda:	N J O F T I M

Njoftim:

Pala Bastri Statoveci është paisur me aktvendim –Leje Urbanistike me datën 28.09.2010 me nr. të landës 18-350-1201/09.

Leja urbanistike është lëshuar në bazë të vendimit të Bordit të Drejtorëve me nr. 01-243-10 të datës 21.09.2010 (që në atë kohë vendimet për lejet ndërtimore lëshoheshin nga Bordi i Drejtorëve), poashtu pala i ka plotësuar kushtet për tu paisur me leje ndërtimore edhe sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor me nr.2003/14, Ligjit të Ndërtimit me nr.2004/15, Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve në Komunën e Obiliqit me nr.01-236/02 si dhe në bazë të Statutit të KK Obiliq neni 69.

Pala ka bërë pagesë prej 10 000 euro më datën 04.10.2010, nga pagesa e përgjithëshme për pagesë 19,890.00 euro.

Pastaj pala nuk ka vazhduar me procedura të mëtutjeshme për t'u paisur me leje ndërtimore ashtu siq parashifet me rregullore, por ndërtimin e ka përfunduar si dhe e ka finalizuar, si dhe për shkak të gjendjes jo të mirë financiare sipas palës që deklaron nuk ka vazhdua me pagese të pjesës së mbeture në vlerë 9,890.00.

Pala tani është e interesura të paiset me leje ndërtimore, mirëpo pasi objekti ka përfunduar dhe për shkak se ka kaluar 8 vite prej se është paisur me leje urbanistike e poashtu pasi në atë kohë Bordi i Drejtorëve ka qenë vendimarrës si dhe organ me i lartë se Drejtoria kurse tani bordi nuk merre vendime për lëshimin e lejeve ndërtimore.

Rekomandim i DPUPK-se eshte qe:

Kuvendi te nxjerr vendim qe Drejtoria per Planifikim Urban Prone dhe Kadaster te vazhdoj me procedura per dhenjen e lejes ndertimore.

NLB PRISHTINA PRISHTINE

WITHDRAWAL FORM

Komuna - Obiliq

Emri i klientit/
Customer name: EJUP STATOVCI

Llogaria nr/
Nr.llog. 1701-0030-212588.26 Saldo /
Balance:

Në llogarinë/Account 10,001.00 EUR Provizio

Me fjale:
In words: tenthousandone

Exchange rate/Exchange rate 1.0000

Withdrawal	RealValueInCurrency	RealCurrency	RestValue	RestCurrency
------------	---------------------	--------------	-----------	--------------

Uniref Acc.: 1000-6502-000000.04 Uniref Name: KOMUNA OBILIQ

Kodi 40

Emri dhe Mbiemri EJUP BASRI STATOVCI

Qellimi i pageses KOMPEZIM PER LEJE NDERTIMI

UNIREF BQU4J111111111117

05.10.2010

Data / Data

0 648 1 30 05.10.2010 11:29

Nënshkrimi digjital

Nënshkrimi h.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

Republika e Kosovës-Republika Kosova
Komuna Obiliq-Opština Obilič
Këshilli i Drejtorëve-Veçe Direktora
ARKIVI-ARHIV
Nr.9r. 01-243-10
Dt. 21.09.2010



KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË
OPŠTINA OBILIČ - KOSOVO
MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetqeverisjen lokale, pas shqyrtimit të propozimit të Drejtorisë për PUKMM- lidhur me kërkesën e qytetarit Bastri Statovci, Kryetari i Komunës më 21.09.2010 mori këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet kërkesa e Bastri Statovci nga Prishtina nr.04-350-1201/10 të dt.05.08.2010 për ndërtimin e objektit- total i ri me destinim-objekt afarist - në parcelën kadastrale nr.1767-8,1768-2,1769-1,1769-2, 1770-1, 1771-2, 1772-2, 1774-4, 1876-0, flet.poseduese nr.01229 në zonën katastrale Obiliq fshati Shkabaj (zona III) KK Obiliq, sipas rregullave dhe dispozitave urbanistike.
- II. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

T'i dorezohet
- Kryetarit të Komunës
- Drejtorit të DPUK
- Drejtorit të DAP
- arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË
OPSTINA OBILIĆ - KOSOVO
MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Drejtorati për Planifikim Urban , Kadastër dhe Pronë
04.Nr/-18- 350-1201/09
Data/28.09.2010

Në bazë të nenit 23 dhe 26 të Ligjit për Planifikim Hapsinor nr. 2003 / 14 , nenit 1 pika 2 pastaj nenet 5,6,7,8,9,10,11,12 dhe 36 të Ligjit mbi ndërtimet nr.2004 / 15, të dt.14 tetor 2004, Rregullores mbi rregullat procedurat për ndërtimin e objekteve në Komunën e Obiliqit nr. 01 – 236 / 02, nenit 69 të Statutit të KK të Obiliqit, **vendimit të bordit të drejtorëve me nr.01-243-10 të dt. 21.09.2010**, gjendjes faktike në teren të marrë nga inspektorët komunal, Drejtorati për Planifikim Urban , Kadastër dhe Pronë, duke vendosur sipas kërkesës së palës **Basri Statovci**, me nr. 04-350-1201/ 2009, dt. 05.08.2009 , për lëshimin e Lejes Urbanistike, në procedurë administrative lëshon këtë:

AKTVENDIM - LEJE URBANISTIKE Për ndërtimin e objektit hotelier-tregtar

I. I CAKTOHEN investitorit –**Bastri Statovci** nga Prishtina, rr. ,, “ nr., kushtet urbanistike-teknike për ndërtimin e objektit afarist “2S+P+2K”, me destinim hotel, në ngastrën kadastrale nr. 1767-8,1768-1,1768-2,1769-1,1769-2,1770-1,1771-2,1772-2,1774-4 dhe 1876, fleta posedues me nr.01229, Zona Kadastrale Obiliq , zona III (tretë) e Komunës, fshati Shkabaj,, Komuna Obiliq .

II Lokacioni per te cilin caktohen kushtet urbanistike –teknike, eshte e destinuar per objekt afarist (meqenese nuk eshte hartuar Plani Zhvillimor Komunal) .

III. Parcela ndërtimore ka formën katrore e thyer me sipërfaqe prej **3 hektar 52 ari e 06 m²**, e drejta pronësore-juridike Basri Statovci, në bazë të dokumentacionit pronësoro - juridik, tokë e ndërtuar.

IV. Kushtet për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar për realizimin e objektit janë:
Gabariti I objektit me dimensione si në pjesën grafike
~ 50.40 m x 43.20 m

- Destinimi i shfrytëzimit të hapësirës –**hotel-**,

- Vija ndërtimore ndaj vijës rregullative dhe kushtet tjera për rregullimin e parcellës ndërtimore të jetë në tërësi sipas normativës ligjore (në mungesë të planeve), largësia nga rruga sipas normave ~ 60 m.
- Kuota e nivelit të përdhësës duhet të jetë e ngritur nga niveli i trotuarit për ____ cm,
- Zgjidhja e kulmit duhet të jetë sipas zgjedhjes së investitorit
- Dukja e jashtme (fasada) e objektit të jetë sipas zgjedhjes, me përdorim të materialit dhe elementeve arkitektonike që i përshtatet ambientit për rreth.

IV. Kyqja në infrastrukturë të bëhet në rrjetin ekzistues pas sigurimit të kushteve detale dhe pëlqimeve paraprake për kyqje nga KEK-u, KUR „Prishtina”

V. Dokumentacioni teknik duhet të përmbajë:

- Situatën e terrenit në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave në përpjesë 1:50
- Përshkrimi teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Llogarinë statike me planin e armaturës;
- Projektet e instalimeve; (ujësjellës, kanalizim, elektrikë dhe mekanike nëse ato parashihen)
- Raporti mbi kontrollimin teknik të dokumentacionit teknik dhe vërtetimi mbi rregullsinë e projektit kryesor.
- Çertifikata e firmës projektuse e licencuar për veprimtarinë përkatëse (së bashku me diplomat e stafit)

VI. Kjo Leje Urbanistike vlen 2 vjet duke llogaritur nga dita e lëshimit. Vazhdimi i vlefshmërisë së kësaj leje mund të bëhet edhe për dy vjet tjera nëse nuk është ndryshuar pjesa e planit urbanistik në bazë të të cilit është lëshuar kjo leje.

VII. Procedura e ndryshimit dhe plotësimit të kësaj Leje Urbanistike mund të bëhet në bazë të kërkesës së investitorit, në procedurën e njejtë e të paraparë për lëshimin e saj.

A r s y e t i m

Pala Basri Statovci nga Prishtina, rr. „____”, nr. ____, me kërkesën nr. 04-350- 1201 /2009 të datës 05.08.2009, ka kërkuar nga Drejtorati për Planifikim Urban, Katastër dhe Pronë, për hartimin e dokumentacionit teknik për ndërtimin e objektit afarist-tregtar, me destinim hotel, në lokacionin e përshkruar në pikën I. të dispozitivit të kësaj leje urbanistike.

Bashkangjitur me kërkesë ka prezentuar

- Provën mbi të drejtën pronëso-ro-juridike të lokacionit në fjalë- fletën poseduese me nr.04-219/09 dhe kopjen e planit me nr.04-326/09 të dt. 04.06.2009 të lëshuar nga Drejtorati,

- Projektin ideor të objektit për të cilin kërkon ndërtimin,
- Kopjen e letërnjoftimit,

Ky organ, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave tjera të bashkangjitura, identifikimit të gjendjes faktike të lokacionit në teren si dhe të rregullativës ligjore nga lëmia e planifikimit

hapësinor dhe asaj nga lëmia e procedurës së përgjithshme administrative konstatoj se, janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për lëshimin e kësaj Leje Urbanistike.

Taksa për aplikimin e kësaj Leje Urbanistike është paguar në lartësinë prej **10 €** konform me tarifën sipas nenit 11.1 të Rregullorës mbi kriteret dhe lartësinë e kompenzimit për rregullimin e tokës ndërtimore nr. **01-402/05** të datës **30.06.2005**.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të kësaj Leje Urbanistike.

Udhëzimi juridik: Kundër kësaj Leje Urbanistike mund të paraqitet ankesë Kryetarit të Komunës së Obiliqit brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Leje Urbanistike. Ankesa dorëzohet përmes këtij Drejtorati.

I dorëzohet:


Palës,
këtij Drejtorati dhe
në arkiv.

28.09.2010

**DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN, KATASTËR DHE PRONË I
KOMUNËS SË OBILIQIT**

Punoi

/ark.Merita Simnica ing./

Kontrolloi

/ _____ ing./

Drejtori

/ Azem Spanca ing./



KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIÇ
MUNICIPALITY OF OBILIÇ

DREJTORIA PËR GJEODEZI, URBANIZEM DHE PRONË
DIREKCIJA ZA GEODEZIJU URBANIZAM I IMOVINË
DEPARTMENT FOR GEODEZI URBANIZEM

FATURË · RAÇUN · INVOICE

Nr. ser - Ser.br - Ser.no
№ 00017

FAXA KOMUNALE PËR LEJE NDËRTIMI

Emri / Mbiemri
no / Prezime
Name / Surname

KA-1234 56789

Përshkrimi
Zps
Description

konstruksion i objektit me adresën
në rrugën nr. 123456789

Shuma
znos
Amount

€ 1000000 Euro Gr. Data
Delum Date 01/10/2010

Te gjithë
fjalimat
in words

objekt me adresën

logona bankare
trajzironçina
bank account

1000650200000004

Eshtuar nga
edato od
signed by

Adresa e adresës

NLB Prichtina sh.a.
05 OCT 2010
Arka nr. 5

nënshkrimi dhe vulë e bankës
potpis i pečat banke
bank signature and stamp

UNIREF



8004311111*11112